

Mozaik i jetës rurale



Ky album fotografik synon të ofrojë një vështrim të Shqipërisë rurale, ku gratë marrin shumë role. Përmban histori të ndryshme të grave dhe vajzave nga zonat e Pukës, Elbasanit dhe Kolonjës, me fokus tek sfidat e jetës së tyre të përditshme, familja, puna dhe koha e lirë.

Falenderojmë Florën, Marien, Beruzen, Ledinën, Marinelën dhe të gjitha vajzat dhe gratë që iu bashkuan kësaj iniciative.

© Rrjeti Shqiptar për Zhvillim Rural & UN Women Albania

Mars 2023

Mozaik i jetës rurale

Ky album fotografik u mundësua nga Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural në rolin e nën-kontraktorit në kuadër të projektit "Fuqizimi i Grave në Zonat Rurale dhe Turizmi" i cili po zbatohet së bashku me UN Women Albania, të financuar nga Qeveria Italiane dhe në partneritet me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

DESIGN: EDUART CANI

BERUZE



MARIE



MARINILLA



FLORA



LEDINA





FLORA



"E dua fshatin por nuk më pëlqen që njerëzit nuk janë vetvetja, nuk arrijnë dot të marrin një vendim të lirë, pa u ndikuar nga të tjerët.

Pas humbjes së bashkëshortit jam përplasur me shume sfida që më duhej t'i kaloja e vetme. Unë punoj si infermiere këtu në fshat, por kisha nevojë për një shoqëri dhe një pasion që të më bënte të ndihesa e gjallë, sepse atëherë isha futur diku në një errësi. Në fillim kisha shumë frikë, por e nxitur pak nga njerëzit dhe pak nga dëshira ime, u njoha me AgroPukën dhe kështu nisi "Zojat e Munellës".

Duke qenë në kontakt me shok e me shoqe, me njerëz të ndryshëm, fillova ta merrja veten dhe kjo më ndihmoi që të punoj akoma më shumë. Kisha idenë që t'i jepja mundësinë edhe grave të tjera të zonës për kultivimin, grumbullimin dhe përpunimin e frutave të egra."

A



FLORA

ESPIRA



R A

FLORA

MOZAIK I JETËS RURALE

"I thash vetes Flora, ti di ta ngasësh, merr makinën dhe ec vet."

Prej shume vitesh Flora i shërben vetes dhe punës së saj. Ajo udhëton për më shumë se një orë sa herë që është nevoja të shkojë në Pukë për t'u takuar me grupin e zonjave, për trajnime apo aktivitete rekreative. Ndjek çdo panair në Tiranë apo qytete të tjera.

"Unë vet shkoj pothuaj në të gjitha aktivitetet, iu them dhe shoqëve por shpesh nuk vijnë, madje bashkëshortët iu thonë mos rri me Florën. Arsyeja e vërtetë që mendoj unë pse nuk i lënë është se nuk duan që gratë e tyre të marrin pavarësi ekonomike dhe kjo nuk i intereson burrave. Është shumë e vështirë por duhet dikush që t'i thyej këto gjëra."

FLORA

FLORA

MOZAIK I JETËS SHQIPTARE RURALE



F L O R A



M A R I E

12 km më tej, në Gjegjan, mentaliteti i zonës nuk i ka ndaluar gratë dhe vajzat të krijojnë grupin e tyre që prej vitit 2004. I përbërë nga gra shtëpiake por edhe të angazhuara në sektorët e mjekësisë, arsimit apo administratës publike, grupi i Gjegjanit sot ka 22 anëtare që angazhohen për përpunimin e prodhimeve të zonës.

Marie, me profesion ekonomiste dhe nënë e 5 fëmijëve, është një nga zonjat iniciatore të krijimit të këtij grupimi.

"Që ditën e parë që jemi ulur në lokal, ka pasur një jehonë, burrat thoshin nga na u mblodhën gjithë këto gra kështu. Deri në vitin 2007 kemi përdorur shtëpinë time si qendër, ishim aty që nga maji kur fillon qershia e pare, e deri në fund me kiuin."



MOZAIK JAMES RURAL

MARIE

MARIE

MARIE

MOZAIK BUKAN RURALE



MARIE



Periudha që Marie dhe Drane kujtojnë të përlotura, është kur grupit iu dha në përdorim nga pushteti vendor një Qendër në mes të fshatit. Për 8 vite me radhë gratë i shërbenin Qendrës dhe Qendra i shërbente grave. Ndihmoi për të mbështetur vajza, gra shtëpiake apo të divorcuara nga ana morale dhe sociale, u zhvilluan kurse rrobaqepësie, për kultivimin e luleve apo punimet e dorës. Por më pas qendra u mbyll. Në vitin 2015, grupit të Gjegjanit iu hoq ambienti nga përdorimi. Sot ato kanë vetëm një hapësirë të vogël larg nga qendra, falë një prej anëtareve të grupit, për të promovuar produktet.

“Që atë ditë ne nuk e kemi ul veten, nuk e kemi ndal aktivitetin. I kemi bërë takimet në lëndina dhe jemi përkushtuar që të gjitha prodhimet që bënim tek Qendra secila t’i bëj nëpër shtëpi, për shembull, njëra grua ka bërë reçelin e fikut, tjetra të qershisë, një tjetër frutat e thata dhe më pas i kemi mbledhur.

Fjala kryesore po të na pyesësh të gjithave është një Qendër. Me të marrë një Qendër që do ishte me të gjitha kushtet, do të merrnim edhe licencën. Do të punonim me rregulla, me orare të caktuara që Qendra të rrinte hapur dhe do të kishim prodhim me sasi më të mëdha.”





LEDINA



“Puna në serë është e lodhshme dhe të priten krahët kur sheh që produkti të zhvlerësohet në treg. Gjithsesi, kur hyn dhe sheh bimën të rritet e bukur, nuk ka kënaqësi më të madhe. Kjo është puna që na mban me shpresë.”

Ledina është 47 vjeç, nga fshati Kuqan, në Elbasan. Më shumë se gjysmën e jetës së saj ia ka dedikuar kultivimit të produkteve në sera, ku çdo ditë punon së bashku me bashkëshortin. Nevoja më e madhe për të është grumbullimi dhe tregu për të shitur prodhimet.

LEDINA

RURALIA



LEDINA

LEDINA



LEDINA

MCZAK I JETES RURALE



Puna e Ledinës nuk mbaron me serën, pasdite ajo shkon në ullishte dhe në pjesën tjetër të kohës kujdeset për familjen. Por prap thotë se “po të duash e gjen kohën e lirë”.


Takimet me shoqet dhe shkëmbimet e eksperiencave me gra në sektorin agro-ushqimor nga zona të tjera, e mbajnë optimiste, ndërsa momentet e lira të ditës ka dëshirë t’ia kushtoj Aksës, qenushit të saj.

“Nuk e kemi menduar kurrë ta lëmë fshatin. Lodhesh pak më tepër, por këtu më pëlqen çdo gjë, duke filluar që nga ushqimet bio, tek natyra dhe ajri i pastër që merr kur ngrihesh në mëngjes.”

LEDINA



LEEDINA



BERUZE




Lodhja për Beruzen nuk njih stinë. Ajo është infermiere, merret me fermën, me vreshtat, kultivon produkte në serë dhe kujdeset për ullinjtë. Nga tetori deri në janar, ditët për Beruzen nuk kanë fund. Ajo dhe bashkëshorti i saj Agroni, janë çdo ditë tek fabrika e vajit të ullirit. Një ambient që i ka dhënë mundësi punësimi dhjetëra banorëve të zonës dhe rreth 125 anëtarëve të federatës, për të prodhuar vaj ulliri ekstra të virgjër.

“Në fshat është mirë me jetu, por ka ngarkesë të madhe pune fizike, sidomos për gratë. E keaja më e madhe është se ka dhe punë të pa paguar. Do apo nuk do, je apo nuk je e lodhur, nuk pret dot që të shplodhesh. Dita tjetër ka ngarkesën e vet.”

R U Z E

BERUZE

MOŽAIK JETĒS RŪMĀLE



BERUZE

BERUZE

MOZAIK I JETËS RURALE



BERUZE



Olio d'Olive di categoria superiore ottenuto direttamente dalle olive e unicamente mediante procedimenti meccanici

VAJ ULLIRI
EKSTRA I VIRGJER

EXTRA VERGINE



VALMI

Prodotto alle antichità regi
"Federata Repubblica Elbana"

Capacità netta: 5L
Adegna: Shqipëri, Elbana, Shqipëri

5 litri e

DA CONSUMARSI PREFERIBILMENTE
E IMMEDIATAMENTE DOPO LA SOSTRACCIONE DEL COPERCHIO

CONSERVARE IN LUCE FRESCA E ASCIUTTA
LONTANO DA FONTE DI CALORE E AL RIPARO DALLA LUCE



VAJ ULLIRI
EKSTRA I VIRGJER

EXTRA VERGINE



VALMI

Prodotto alle antichità regi
"Federata Repubblica Elbana"

Capacità netta: 0,5L
Adegna: Shqipëri, Elbana, Shqipëri

VAJ ULLIRI
EKSTRA I VIRGJER

EXTRA VERGINE



VALMI

Prodotto alle antichità regi
"Federata Repubblica Elbana"

Capacità netta: 1L
Adegna: Shqipëri, Elbana, Shqipëri

Kohën e lirë e ka të pakët, por kjo nuk e ka penguar Beruzen të formojë grupin e grave në Shirgjan për të biseduar problematika, për të marrë pjesë në panairë apo aktivitete të tjera.

"Në fillim ishim vetëm dy gra dhe e kam pasur pak të vështirë t'i bind, se nuk i linin aq kollaj, iu thoshin ku do shkosh ti pa burrin. Por sot është tjetër gjë, kemi krijuar një grup me 12 persona dhe janë të gjitha gati kudo që të kemi aktivitete sepse është një ndër mundësitë e pakëta për t'u shpërndur fizikisht e për të dalë nga rutina."

BERUZE

MOZAIK I JETĒS RURALE



BERUZE



MARINELA



Paditët në shtëpinë e Marinelës në Leskovik kalojnë mes bisedash dhe kafes me mikeshat e saj. Varfëria, thotë Marinela se merr kohën më të madhe të diskutimit, mungesa e vendeve të punës, shërbimeve dhe mbi të gjitha, mungesa e tregut për produktet që ato kultivojnë. Rakia dhe vera janë traditë ndër breza në Leskovik. Edhe sot, çdo shtëpi vazhdon të prodhojë, por në mungesë të tregut dhe një pike grumbullimi, çdo vit, dhjetëra e qindra litra alkool mbeten të pa shitura.

Deri pak muaj më parë, vreshtat dhe ndihma ekonomike prej 65 mijë lekësh të vjetra, ishin i vetmi burim të ardhurash për familjen me katër anëtarë të Marinelës. Por ata duan ta ndryshojnë, bashkëshorti sapo ka nisur të punojë në ndërtim, ndërsa Marinela i është bashkuar trajnimeve për zhvillim të qëndrueshëm vendor në bashkinë e Kolonjës.

M A R I N E L A

MARINELA

MOZAIK I. JETĚS RURALE



MARINELA

MOZAIK I JETËS RURALE

MARINELA

MARINELA



"Më lajmëruan tek zyrat e ndihmës ekonomike që do të zhvilloheshin disa trajnime. Deri tani të katër trajnimet i kam ndjekur me shumë interes, qoftë për pjesën se si të punojmë në grup apo të zhvillohemi më tepër. Ne produktet dhe gatimet i kemi bërë gjithmonë, por trajnimi po na ndihmon të kuptojmë më mirë çfarë mundësisë dhe nevojash ka Leskoviku.

Unë e di që jam e zonja t'ia dal mbanë dhe nëse do të më jepej mundësia të gjeja një punë të shisja produktet që prodhoj, kjo do ma bënte shpirtin të punoja edhe më shumë."

MOZAIK I JETËS RURALE

MARINELA



MARINELA



Mozaik i jetës shqiptare rurale

www.anrd.al

